



**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
(Auditim Tematik)**

**“Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2021,
në Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit,
Tiranë**

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT**

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021" NË DRAKU TIRANË

PËRMBAJTJA			
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1.Përshkrim i shkurtër i projektit të Auditimit	3
		2.Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
		3.Konkluzioni i përgjithshëm	3
II.	HYRJA	1. Objektivi i Auditimit	4-6
		2. Qëllimi i Auditimit	
		3. Identifikimi i çështjes	
		4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
		5. Përgjegjësitë e audituesve	
		6. Kriteret e Vlerësimit	
		7. Standardet e auditimit	
		8. Metodot e auditimit	
		9. Dokumentimi i auditimit	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT		6-21
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim		6
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit		6
2.1	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".		6
2.2	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.		8
2.3	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.		8-17
2.4	Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.		18-19
2.5	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.		20-21
2.6	Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.		21-22
IV	GJETJE DHE REKOMANDIME		22
V	DOKUMENTACION SHOQËRUES		22



I. PËRMbledhje Ekzekutive

I.1. Përshkrim i shkurtër i projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1153/22, datë 15.9.2021 ka dërguar Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse. Kjo shkresë është protokolluar në DR AKU me nr. 1808 prot., datë 17.09.2021. Nga titullari i institucioni është nxjerrë Urdhër për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH. Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse nr. 1153/22 prot, datë 15.9.2021 janë lënë 63 rekomandime gjithsej, nga këto: 32 masa organizative, 9 masa zhdëmtimi në vlerën 4,146,175 lekë, 2 masa për eliminimin e efekteve negative financiare, 20 masa disiplinore, nga "Vërejtje" deri në "Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna" për 20 punonjës.

I.2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore të auditimit

Nga DRAKU Tiranë paraqitet një nivel i lartë i zbatimit të rekomandimeve, ku nga 63 rekomandime janë zbatuar dhe në proces zbatimi 91% e rekomandimeve të lëna nga KLSH. Niveli i pa zbatueshmërisë paraqitet në masën 9%, për rekomandime të cilat nuk janë pranuar nga subjekti.

Për masat organizative, DRAKU Tiranë nuk ka pranuar rekomandime si më poshtë:

-DRAKU Tiranë dhe DRAKU nuk ka pranuar dhe zbatuar rekomandimin 1.1 që në bashkëpunim me MBZHR, në mbështetje të neneve 111, 113 dhe 114 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të marrin masat e nevojshme, për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve të mësipërme për 21 gjobat, me qëllim anulimin e tyre dhe rivendosjen e ligjshmërisë, si dhe përcjelljen 19 gjobave (përfshirë 2 gjoba të cilat janë në shkallën e dytë të gjykimit) pranë Komisionit të posaçëm në MBZHR për shqyrtimin nga e para dhe vendimmarrje të mëtejshme".

-DRAKU Tiranë nuk ka pranuar dhe zbatuar rekomandimin 6.1 që të marrë masat e nevojshme që për çdo mostër të sjellë nga kontrolli zyrtar, treguesit që do të analizohen të përcaktohen nga specialistët e laboratorit, si dhe nga inspektorët në fletë-shoqërimin e mostrës të përcaktohet qartë se në çfarë kushtesh është ruajtur produkti prej nga është marrë mostra, duke shërbyer si tregues për laboratorin në përcaktimin e treguesit që do të analizohet.

-DRAKU Tiranë nuk ka pranuar dhe zbatuar rekomandimin nr. 10.1 që të marrë masat e nevojshme, që në çdo rast të refuzimit të aplikimit për licencim, të bëjë ndalimin e ushtrimit të aktivitetit si dhe përcaktimin e afatit konkret për rregullimin e mangësive".

-DRAKU Tiranë nuk ka pranuar dhe zbatuar rekomandimin nr. 13.1 që për çdo rast kur është e nevojshme përfshirja e një inspektori të një sektori të caktuar pranë drejtorisë (pra inspektori i sektorit të bimëve të kryeje inspektive në subjekte që tregtojnë produkte me origjinë shtazore ose anasjelltas), në kryerjen e inspektiveve për llogari të sektorit tjetër, t'i bëjë propozim Drejtorit të Përgjithshëm të AKU- së, me qëllim miratimin nga ky i fundit, me urdhër caktimi të Lëvizjes/transferimit paralel të inspektorit".

I.3. Konkluzioni i përgjithshëm

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes nga **32 masa organizative** të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 26 rekomandime, në proces zbatimi 1 rekomandim dhe pa zbatuar janë 5 rekomandime të cilat nuk janë pranuar nga subjekti.

Masa shpërbllim dëmi janë lënë **9 rekomandime** në vlerën 4,146,175 lekë (pranuar 7, pranuar pjesërisht 1, papranuar 1, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 5 rekomandime 332, 175 lekë, pjesërisht janë zbatuar 3 rekomandime dhe 1 rekomandim është i pa pranuar dhe i pazbatuar .

Masa për eliminimin e efekteve financiare (3E) janë 2 masa nga të cilat 1 është zbatuar dhe 1 rekomandim është në proces zbatimi.

Masa disiplinore janë lënë gjithsej 20 rekomandime, të cilat janë zbatuar në masën 100%.



II - HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 162/4 datë 14.02.2022 nga data 28.02.2022 deri në datën 18.03.2022, në Drejtorinë Rajonale të AKU-s Tiranë. KLSH kreu auditimin e përputhshmërisë “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2021”.

Auditimi përputhshmërisë u krye nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A. M, Përgjegjës Grupi
2. R. A, antare.

Nga grupi i auditimit u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, një kopje e të cilit i dërgohet DPASHK Tiranë dhe një kopje protokollohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

1. Titulli - Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e ushtruar sipas programit nr. 1155/1, datë 11.01.2021, të miratuar nga Kryetari i kontrollit të Lartë të Shtetit

2. Marrësi – Drejtorinë Rajonale të AKU-s Tiranë.

3. Objektivat dhe qëllimi

Objektivat: Mbi dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë, si dhe dhënien e opinionit objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në përmirësimin e punës menaxhuese të njësive publike.

Qëllimi: Raportimi dhe evidentimi i gjetjeve, nxjerrja e konkluzioneve dhe rekomandimet e auditimit.

4. Identifikimi i çështjes

DRAKU Tiranë, duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj taksapaguesit, duke patur në fokus kryesor, garantimin e ushqimit të sigurt dhe cilësor. Auditimi u fokusua në fushat e aktivitetit të DRAKU Tiranë, sipas vlerësimit dhe kategorizimit të riskut (i lartë, i mesëm dhe i ulët).

5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

DRAKU Tiranë ka si funksion:

- a) kontrollin paraprak për të vërtetuar nëse janë plotësuar kërkesat tekniko-teknologjike, higjienosanitare, fitosanitare dhe veterinarë, verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin dhe licencimin e operatoreve të biznesit ushqimor, ushqimit për kafshë, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve;
- b) kontrollin zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, si dhe në fushën e mbrojtjes së bimëve në territorin e qarkut përkatës;
- c) kontrollin zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, mbrojtjes së bimëve në njësitë e inspektimit kufitar;
- d) Ndalon, përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, veprimtarinë e operatorëve të biznesit të ushqimit dhe të atij të ushqimit për kafshë në fazat e prodhimit, përpunimit, shpërndarjes dhe tregtimit të ushqimit apo ushqimit për kafshë, kur vërtetohet se ushqimi a ushqimi për kafshë dhe operatorët përkatës të biznesit nuk plotësojnë standardet e sigurisë ushqimore, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

-Procedura e inspektimit inicohet me lëshimin e autorizimit nga Kryeinspektori i DRAUK Tiranë, në të cilin përcaktohet subjekti, kohëzgjatja, çfarë do të inspektohet, si dhe grupi i inspektorëve.

Nga grupi i inspektorëve, gjatë inspektimit në terren, pranë subjektit, plotësohet listë-verifikimi, procesverbali i inspektimit, në të cilin pasqyrohen veprimet, shkeljet, lihet detyrë



për dorëzim dokumentacioni, marrje mostrash për analizë laboratorike, si dhe vendimi përfundimtar i inspektimit i cili merret nga grupi i inspektimit.

Çdo sektor i inspektimit ka planin vjetor të inspektimit, i cili përgatitet nga Drejtoria Rajonale, më pas dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme, e cila bënë konsolidimin e tij me planet e Drejtorive të tjera rajonale, dhe ky plan i konsoliduar i dërgohet Inspektoratit Qendror për mendim. Pas dhënies së mendimit nga Inspektorati Qendror, plani vjetor i inspektimit miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në rolin e institucionit epror të AKU. -Gjithashtu çdo sektor i inspektimit ka planin për marrjen e mostrave në terren, nga subjekte të ndryshme.

6. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi duhet të respektojë kërkesat etike, duke planifikuar e kryer auditimin me qëllim arritjen e nivelit të sigurisë së kërkuar.

7. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikat e trajtuara, janë marrë në konsideratë si kriter vlerësues, Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i ndryshuar; Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr. 107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së; Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr. 67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), "Udhëzuesit e INTOSAI-t"; Udhëzues të përgjithshëm dhe specifik për auditimin, si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare të fushës së auditimit publik; Ligji nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin".

8. Standardet e auditimit

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr. 107, datë 08.08.2017, Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr. 67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

9. Metodatat e auditimit

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodatat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.

Verifikimi i Urdhrave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

10. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Zbatimit të Rekomandimeve dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit". Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur një akt-verifikim sipas çështjeve respektive të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmbyllës me përfaqësuesit e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.



I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Tiranë, ka si mision garantimin e shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtjen e konsumatorit, në të gjitha fazat e prodhimit primar, trajtimit, përpunimit, dhe shpërndarjes së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë. Gjithashtu kjo Drejtori ka si objektiv, kryerjen e inspektimeve, marrjen dhe analizimin e mostrave, nga ushqimet me origjinë shtazore dhe ushqimet me origjinë jo-shtazore, si dhe bimët, produktet plehëruese. DRAKU Tiranë, deri më datën 14.09.2020 është organizuar dhe ka funksionuar sipas përcaktimeve ligjore të bëra në VKM nr. 1081, datë 21.10.2009 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit", e ndryshuar, dhe pas datës 14.09.2020 e në vijim, është e organizuar dhe funksionon sipas përcaktimeve ligjore të bëra në VKM nr. 708, datë 09.09.2020. DRAKU Tiranë, e shtrin juridiksionin e vet në Qarkun Tiranë, duke përfshirë Bashkinë Tiranë, Kavajë dhe Rrogozhinë.

Struktura e DRAKU Tiranë është miratuar me Urdhrin nr. 119, datë 10.03.2014 të Kryeministrit, dhe është e organizuar në nivel Drejtorie dhe Sektori. Niveli i drejtorisë përfaqësohet nga Kryeinspektori i DRAKU (1 punonjës), i cili drejton Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-shtazore dhe Operatorëve të Biznesit (20 inspektor); Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit (16 inspektor); Sektorin e Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore (5 inspektor); Sektorin e Shërbimeve Laboratorike Fiziko-Kimiku dhe Mikrobiologjiku (1 përgjegjës dhe specialist); Sektori i Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, PIK (6 inspektor, nga të cilët 2 inspektor për produktet me origjinë jo-shtazore, 2 inspektor për produktet me origjinë shtazore dhe 2 inspektorë për produktet e mbrojtjes së bimëve) dhe Sektorin e Shërbimeve të Brendshme (1 përgjegjës, 2 specialist dhe 1 sanitar), pra në total në organikën e DRAKU Tiranë janë 58 punonjës.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1 Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1153/22 prot, datë 15.9.2021 ka dërguar Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse. Kjo shkresë është protokolluar në DR AKU me nr. 1808, datë 17.09.2021.

- Nga titullari i institucioni është nxjerrë Urdhër për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, por për zbatimin e tyre janë marrë masa nga specialistët e të gjithë sektorëve përkatës të prekur në Raportin Përfundimtar të KLSH, rast pas rasti sipas detyrave të gjithsecilit.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse nr. 1153/22 prot, datë 15.9.2021 janë lënë **63 rekomandime** gjithsej, nga këto: **32 masa organizative, 9 masa zhdëmtimi në vlerën 4,146,175 lekë, 2 masa për eliminimin e efekteve negative financiare, 20 masa disiplinore**, nga "Vërejtje" deri në "Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna" për **20 punonjës**.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes nga **32 masa organizative** të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 26 rekomandime, në proces zbatimi 1 rekomandim dhe pa zbatuar janë 5 rekomandime të cilat nuk janë pranuar nga subjekti.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021" NË DRAKU TIRANË

Masa shpërblim demi janë lënë **9 rekomandime** në vlerën 4,146,175 lekë (pranuar 7, pranuar pjesërisht 1, papranuar 1, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 5 rekomandime 332, 175 lekë, pjesërisht janë zbatuar 3 rekomandime dhe 1 rekomandim i pa pranuar dhe i pazbatuar .

Masa për eliminimin e efekteve financiare (3E) janë 2 masa nga të cilat 1 është zbatuar dhe 1 rekomandim është në proces zbatimi.

Masa disiplinore janë lënë gjithsej 20 rekomandime, të cilat janë zbatuar në masën 100%.

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :				Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:					
			Zbatuar	Në proces/pjesërisht	Pa zbatuar	Nr. per	Në mijë/lek	Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht (në proces)		Pa zbatuar	
								Nr. per	Në mijë/lek	Nr. Pers	Në mijë/lek	Nr. per	Në mijë/lek
1.	Masa organizative	32	26	1	5								
2.	Masa për përmirësim ligjor												
3.	Shpërblim demi	9	5	3	1	9	4146175	5	332,175				
4.	Masa efekt financiar	2	1	1									
5.	Masa disiplinore	20	20										
	Totali	63	52	5	6								

III.2 Zbatimi i rekomandimeve për përmirësim në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga auditimi rezultoi se nuk ka patur masa me karakter të përmirësimit ligjor

III.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 1.1:

“DRAKU Tiranë dhe DPAKU në bashkëpunim me MBZHR, në mbështetje të neneve 111, 113 dhe 114 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës



së Shqipërisë", të marrin masat e nevojshme, për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve të mësipërme për 21 gjobat, me qëllim anulimin e tyre dhe rivendosjen e ligjshmërisë, si dhe përcjelljen 19 gjobave (përfshirë 2 gjoba të cilat janë në shkallën e dytë të gjykimit) pranë Komisionit të posaçëm në MBZHR për shqyrtimin nga e para dhe vendimmarrje të mëtejshme".

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim **nuk është pranuar** nga subjekti i audituar.

Qëndrimi i mbajtur në observacionet dhe plan veprimin e zbatimit të rekomandimeve: Për 19 gjobat për të cilat komisioni i ankimimit ka marrë një vendim, për shfuqizimin e tyre, me arsyetimin sipas grupit të auditimit të KLSH-së, në mungesë të kompetencës, subjekti i audituar, e konsideron këtë rekomandim të pa pranuar nga ana e tij. Argumentimi në lidhje me kompetencën ligjore, është paraqitur edhe me observacion, si dhe në takimin ballafaques, ku siç rezultoi edhe atje, AKU i është referuar Ligjit dhe jo VKM-së në lidhje me këtë çështje, duke vlerësuar se Ligji, prevalon mbi VKM. Fakti që Ligji dhe VKM-ja kanë zgjidhje të ndryshme (në kundërshtim me njëra-tjetrën) në lidhje me shqyrtimin e masave administrative deri ditën e daljes së VKM-së, që krijon komisionin e ankimimit në Ministrinë e Linjës, nuk është përgjegjësi e AKU-së. Nga ana tjetër, AKU nuk ka të drejtën e nismës ligjore për ndryshimet përkatëse pasi kjo është e drejtë e Ministrisë së linjës. Gjithashtu edhe nisma për ndryshime të akteve rregullative, konsiderohet jo efektive për faktin se shumica e ankimimeve të paraqitura, përpara daljes së VKM-së që krijon komisionin e ankimimit në Ministri, tashmë janë shqyrtuar nga komisioni i ankimimit në AKU. Ndërkohë rikujtojmë se nga komisioni i ankimimit të AKU-së, janë lënë në fuqi shumica e gjobave të aplikuara dhe referuar trajtimit Tuaj, duhet që edhe gjobat që janë lënë në fuqi, të anulohen dhe ti kalojnë për shqyrtimin komisionit të ankimimit në Ministri. Bëjmë me dije gjithashtu se pikërisht për këto gjoba që Ju i keni konsideruar se janë shqyrtuar (Ju keni marrë në shqyrtim vetëm gjobat e falura dhe jo ato të lëna në fuqi që përbëjnë shumicën, rreth 90 %), jashtë kompetencave të komisionit të AKU-së, ne kemi vendime Gjykatash, nëpërmjet të cilave janë pranuar kërkesat për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit, natyrisht pasi kemi paraqitur vendimet e komisionit të ankimimit pranë AKU-së, pra gjykata ka konsideruar të drejtë, shqyrtimin e gjobave nga komisioni i AKU-së dhe jo i Ministrisë dhe këtë ajo nuk e ka konsideruar si mungesë kompetence. Për sa më sipër, rekomandimi Juaj konsiderohet i pa pranuar nga subjekti i audituar

Rekomandimi 1.2:

"DRAKU Tiranë, në bashkëpunim me DP AKU, **për 2 gjobat**, të cilat kanë qenë në shkallën e dytë të gjykimit, të marrin masat e nevojshme për ndjekjen e ecurisë së procesit në Gjykatën Administrative të Apelit".

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar** nga DR AKU Tiranë. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerr shkresa nr. 1958 prot., datë 07.10.2021 "Drejtuar Gjykatës së Apelit", Shkresa Nr. 1958/1 prot., datë 18.10.2021 (Për dy gjobat që janë në shkallën e gjykimit në Apel, DR AKU Tiranë ka ndjekur ecurinë e procesit, çështjet janë regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, por nuk kanë ende datë të planifikuar nga gjyqtari Relator, aktualisht po gjykohen çështjet e regjistruara në vitin 2016. (shkresa "Kërkesë për Informacion" Nr. 1958 Prot., datë 7.10.2021, Shkresa "Kthim Përgjigje" Nr. 1958/1 Prot., datë 18.10.2021).

Rekomandimi 2.1:

"Titullari i DRAKU Tiranë, për rekomandimet nr. 1, 2, 3, dhe 5, të lëna në auditimin e mëparshëm, të marrë masat e nevojshme për analizimin dhe vlerësimin e mundësisë së zbatimit të tyre".

Menjëherë



Komente: Ky rekomandim konkretisht rekomandimi nr. 1, 2, 3 të pazbatuar nga auditimi i mëparshëm ndiqen nga AKU.

Pika 1: e cila ka të bëjë me nxjerrjen e përgjegjësi të punonjësve të DP AKU, konkretisht Sektori Juridik, sqarojmë se këta punonjës kanë ndërprerë e mardhëniet e punës me institucionin mbi 5 vjet e për rrjedhojë marrja e masave kundrejt punonjësve është e pamundur. Rekomandimi 2: i cili ka të bëjë 1) kontabilizimin e gjobave, 2) procedurat për vënien në ekzekutim të tyre (arkëtimit), 3) hedhjen e tyre në sistemin AKU-net, për të cilat sqarojmë si më poshtë:

- 1- Në lidhje me kontabilizimin e gjobave bëjmë me dije se ky rekomandim është zbatuar dhe kontabilizimi është reflektuar me bilancin e vitit 2015;
- 2- Në lidhje me vënien në ekzekutim të gjobave (arkëtimet) ky rekomandim konsiderohet pjesërisht i zbatuar për faktin se ka përpjekje për vënien në ekzekutim të tyre konkretisht, detyrimi i evidentuar nga KLSH-ja në raportin e vitit 2015 ishte 19.831.000 lekë, ndërsa detyrimi i mbetur në muajin Qershor 2022 për periudhën e evidentuar nga grupi auditues i KLSH-së është 16.100.000 lekë pra kemi arkëtim në vlerën 3.731.000 lekë.
- 3- Në lidhje me rekomandimin që ka të bëjë me hedhjen e masave administrative (gjobë) në sistemin AKU-net sqarojmë se sistemi prej kohësh (rreth 4-5 vjet) është marrë në administrim nga AKSH-i dhe ka hyrë në procesin e përmirësimit dhe përshtatjes së tij me kërkesat e AKU-së. Aktualisht janë lidhur kontratat e bashkëpunimit për përmirësimet përkatëse. Bashkëlidhur shkresat nr. 2623/1 prot., datë 11.05.2022, shkresa nr. 4777/1 prot., datë 17.08.2022, shkresa nr. 4957 prot. datë 11.08.2022.

5. Konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar** nga DR AKU Tiranë rekomandimi nr. 5, Dokumentacioni për regjistrimet e pronësisë (ndërtesat e DRAKU-ve), procesin e ndjek Sektori i Buxhetit dhe Financës si dhe një grup pune i ngritur në MBZHR për hipotekimin e 9 godinave të AKU-së në qarqe. (E-mail mbi procesin e hipotekimit datë 10.6.2022 I DP AKU, shkresat nr. 2501 Prot., datë 15.12.2021, Nr. 138 Prot., datë 25.1.2022, Nr. 668 Prot., datë 30.3.2022, Nr. 1935 Prot., datë 10.5.2022, Nr. 1335/2 Prot., datë 28.7.2022, shkresa 4599 prot., datë 08.08.2022).

Rekomandimi 3.1:

“DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DP AKU të marrë masa për kalimin pranë rezervave shtetërore të pajisjeve dhe sendeve të sekuestruara/konfiskuara, përkatësisht 5 frigoriferë, 3 peshore, 80 çengela, 6 thika, 5 hanxharë, sipas fletë-hyrjes nr. 2, datë 07.05.2018 të AKU.”

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar** nga DR AKU Tiranë.

Në zbatim të këtij rekomandimi rezultojnë shkresat “Mbi paraqitjen e dokumentacionit të Inspektimeve, për rastet e konfiskimeve”, Nr. 2363 Prot., datë 30.3.2018, Proces-Verbal dorëzimi datë 7, fletë inventari e mjeteve të konfiskuara, fletë hyrje në magazinën e DP AKU). Sendet janë dorëzuar në magazinën e DP AKU. Nga ana e saj DP AKU i është drejtuar shkresërisht (shkresa nr 5425 prot., datë 15.09.2022) Drejtorisë Rajonale të Rezeravave Materiale të Shtetit, konkretisht për dorëzimin e materialeve të dhëna në rekomandimin e grupit të auditimit KLSH-së.



Rekomandimi 4.1:

“DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DP AKU, për subjektet e inspektuara në bazë të këtij vlerësimi, të bëhet ndryshimi i kategorizimit të riskut të tyre (i lartë, i mesëm, i ulët) e për rrjedhojë edhe frekuenca e inspektimit të tyre”.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2021

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerr urdhër Nr. 3005, datë 20.05.2022 “për ngritjen e grupit të punës, DR AKU Tiranë në bashkëpunim me DP AKU ka bërë ndryshimin i vlerësimit të riskut për subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e ushqimit, ku vlerësimi është bërë në dy hapa (Pikëzimi A: Vlerësim në bazë të llojit të aktivitetit + pikëzimi B: Vlerësimi në bazë të historikut të inspektimeve ndër vite). Mbledhja e dy pikëzimeve nxjerr vlerësimin përfundimtar të subjektit.

Rekomandimi 4.2:

“Gjithashtu në planin vjetor të planifikohen të gjitha subjektet për inspektimi pa diferencime, si dhe ai dhe planet mujore ti përcillen për mendim Inspektoratit Qendror dhe më pas të miratohen nga Titullari i institucionit.”.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2021

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**, në zbatim të këtij rekomandimi, planifikimi i inspektimeve për vitin në vijim është kryer referuar metodikës së përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së. Gjithashtu në mënyrë periodike nga DRAKU-Tiranë është dërguar plani mujor për mendim në Inspektoratin Qendror, njoftohet plani i punës çdo muaj në Drejtorinë e Përgjithshme e cila e përcjell pranë Inspektoratit Qendror (Bashkëngjitur shkresat nr. 871, datë 1.11.2021, nr. 3673, datë 25.07.2022, nr. 5083, datë 12.09.2022).

Në vijim të zbatimit të këtij rekomandimi sqarojmë se DP AKU ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të reflektuar rekomandimet e dhëna nga grupi auditimit të KLSH-së. Bashkëlidhur do të gjeni evidencat mbështetëse nr. 4824, datë 15.08.2022, drejtuar Ministrit të Linjës dhe Kryeinspektorit të IQ si dhe urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së nr. 2738, datë 11.05.2022.

Rekomandimi 5.1, 5.2:

“DP AKU në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, të marrin masat për kryerjen e investimeve të nevojshme në përmirësimin e kushteve të laboratorit (dhoma e pranimit dhe e qëndrimit të mostrave, sistemin e kondicionimit, aspirimit), si dhe kalibrimin dhe vënien në funksion të plotë të aparaturave laboratorike, me qëllim rritjen e saktësisë dhe besueshmërisë së rezultateve të analizave laboratorike”.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2021

Komente: Për pikën 5.1, **Zbatuar**, janë ndërmarrë hapat e nevojshme për të kryer vlerësimet përkatëse për gjendjen e laboratorëve për efekt akreditimi. Bashkëlidhur shkresa nr. 4395 prot., datë 13.10.2020.

Për pikën 5.2: **Zbatuar**, sqarojmë se AKU ka kërkuar investimet e domosdoshme, ministrisë së linjës për përmirësimin e kushteve të rrjetit të laboratorëve, bashkëlidhur shkresa nr. 1144, datë 19.03.2021. Gjithashtu kanë filluar procedurat për pajisjen e laboratorëve me mjetet e duhura me qëllim realizimin e kryerjes së analizave me cilësi dhe brenda afateve ligjore. Bashkëlidhur shkresa drejtuar APP me nr. 1843/4, datë 09.05.2022, shkresa nr. 2459/5, datë 11.05.2022 dhe shkresa nr. 2702/6, datë 27.05.2022. Gjithashtu bashkëlidhur do të gjeni edhe aktet e mbajtura nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, në lidhje me kalibrimin e aparaturave që administrohen në laboratorin Tiranë, respektivisht certifikatë kalibrimi nr. LL-1221D104 dhe LL-0322F1150.



Rekomandimi 6.1:

"DP AKU të marrë masat e nevojshme që për çdo mostër të sjellë nga kontrolli zyrtar, treguesit që do të analizohen të përcaktohen nga specialistët e laboratorit, si dhe nga inspektorët në fletë-shoqërimin e mostrës të përcaktohet qartë se në çfarë kushtesh është ruajtur produkti prej nga është marrë mostra, duke shërbyer si tregues për laboratorin në përcaktimin e treguesit që do të analizohet."

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2021

Komente: Ky rekomandim është i **pa pranuar**, shpjegimet janë dhënë në planin e veprimtimit.

Rekomandimi 7.1:

"DR AKU dhe DP AKU të marrin masat e nevojshme, duke analizuar dhe vlerësuar mundësitë e investimit për blerjen e dhomave frigoriferike ose marrjen me qira të tyre, me qëllim që produktet, të cilat bllokohen gjatë inspektimit dhe që do të asgjësohen, të ruhen në këto ambiente. Nëse ky proces finalizohet, të sigurohen minimalisht 4 dhoma frigoriferike, pra 1 dhomë në dispozicion të 3 Qarqeve, më konkretisht dhoma frigoriferike për DRAKU Tiranë të shërbejë dhe për DRAKU Elbasan dhe Durrës, si dhe shërbimi i ruajtjes së produkteve të bllokuara në subjektet e inspektuara, t'u tarifohet atyre, deri në momentin e asgjësimit. Në këtë mënyrë çdo produkt, i cili bllokohet sipas përcaktimeve të Ligjit të Ushqimit, nuk do t'i lihet në ruajtje subjektit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësitë, që produkti të futet përsëri në treg."

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2021

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe i **zbatuar nga** DR AKU përdorim pajisjet frigoriferike që kemi në dispozicion. Është kërkuar edhe asistencë e DP AKU shkresa Nr. 4920 Prot., datë 6.9.2022. Nga ana e saj DP AKU ka filluar procedurat për të rritur kapacitetin frigoriferike siç paraqiten në shkresat nr. 1843/4, datë 09.05.2022, shkresa nr. 2459/5, datë 11.05.2022 dhe shkresa nr. 2702/6, datë 27.05.2022. Investimi në dhoma frigoriferike mbetet opsion i hapur por që aktualisht nuk është konkretizuar pasi aktualisht nuk shihet si një investim akut për tu kryer.

Rekomandimi 8.1:

"DRAKU Tiranë të marrë masat e nevojshme, që çdo procedurë asgjësimi, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë edhe procesverbali i asgjësimit i mbajtur nga inspektorët e tatimeve, mjedisit dhe ushqimit; Dokumenti i transferimit të mbetjeve; Fletë-Dalja nga magazina e subjektit privat; Kontrata e shërbimit; Fatura tatimore e shërbimit, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese//transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill"

Në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe i **zbatuar**. Në zbatim të këtij rekomandimi çdo procedurë asgjësimi është kryer referuar legjislacionit në fuqi. Bashkangjitur praktikë e mbajtur Nr. AKU-TR-2022-004712, datë 08.09.2022, Nr. AKU-TR-2022-004447, datë 06.07.2022,

Rekomandimi 9.1:

"DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marrin masat e nevojshme, që të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjitës për bllokimin e produkteve, plumbçe për bllokimin e aktivitetit/linjës së prodhimit, këtu mund të referoheni praktikës që ndjekin autoritetet doganore/Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial), me qëllim që në çdo praktikë bllokimi të përdoren shenjat dalluese dhe përdorimi i tyre të përcaktohet si detyrim ligjor në rregulloren e brendshme të institucionit"

Menjëherë dhe në vijimësi



Komente:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Në zbatim të këtij rekomandimi, Fletë–Hyrje nr.2, datë 17.1.2022, Fletë-Dalje nr. 4, datë 17.1.2022. Çdo procedurë e cila shoqërohet me bllokim të ambienteve dhe produkteve, vendosen shenjat dalluese të bllokimit), shembull praktika Nr. AKU-TR-2022-003077, datë 30.04.2022.

Rekomandimi 10.1:

“DRAKU Tiranë të marri masat e nevojshme, që në çdo rast të refuzimit të aplikimit për licencim, të bëjë ndalimin e ushtrimit të aktivitetit si dhe përcaktimin e afatit konkret për rregullimin e mangësive”.

Në vijimësi

Komente:

Ky rekomandim konsiderohet **se është i pazbatueshëm**, referuar plan veprimit dhe observacioneve të paraqitura për faktin se: verifikimi i kushteve për pajisjen me licencë, presupozon që subjekti nuk zhvillon aktivitet në momentin e inspektimit dhe në këtë kontekst subjektit nuk ka çfarë ti ndalohet. Nëse subjekti konstatohet se po zhvillon aktivitet (aktiviteti i cili kërkon licencë) ai penalizohet në kushtet e flagrancës.

Rekomandimi 10.2:

“Gjithashtu në çdo praktikë licencimi të administrohet aplikimi i subjektit, dokumentacioni i dorëzuar nga ai (certifikata kualifikimi, certifikata cilësie, të higjienës, të pajisjeve etj.), si dhe të dokumentohet me foto çdo verifikim i kryer në subjekt, për vlerësimin e plotësimit të kushteve për licencim”.

Në vijimësi

Komente:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar pjesërisht** dhe **i zbatuar**, sepse dokumentacioni i licencimit administrohet jo vetëm nga sistemi por edhe pranë sektorit përkatës në DP AKU. Pranohet pjesa e dokumentimit të plotësimit të kushteve të licencimit (me foto, dokumente, etj.). Në zbatim të këtij rekomandimi bashkëngjitur gjeni praktikën si shembull Nr. AKU-TR-2021-006971, datë 14.12.2021, praktikën Nr. AKU-TR-2022-004767, datë 09.09.2022 me dokumentacionin e plotë dhe aplikimin e subjektit.

Rekomandimi 11.1:

“Gjithashtu në çdo praktikë licencimi të administrohet aplikimi i subjektit, dokumentacioni i dorëzuar nga ai (certifikata kualifikimi, certifikata cilësie, të higjienës, të pajisjeve etj.), si dhe të dokumentohet me foto çdo verifikim i kryer në subjekt, për vlerësimin e plotësimit të kushteve për licencim”.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2021 dhe në vijimësi

Komente:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar pjesërisht** dhe **i zbatuar**. Në çdo procedurë në të cilën është lënë rikontroll, janë kryer verifikimet përkatëse në vijimësi. Bashkëngjitur praktike model e mbajtur Nr. AKU-TR-2022-003804, datë 17.06.2022.

Rekomandimi 12.1:

“DRAKU Tiranë të marri masat e nevojshme, që çdo procedurë mostërmarrje, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë: Autorizimi i inspektimit, listë-verifikimi, procesverbali standard i inspektimit, fletë-shoqërimi i mostrës në laborator, raport-prova, vendimi përfundimtar i inspektimit, i cili merret në momentin e përgjigjes së rezultatit të analizës laboratorike”.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2021 dhe në vijimësi



Komente:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Në zbatim të këtij rekomandimi Bashkëngjitur fletë shoqërimi mostre në Laborator, Praktika Nr. AKU-TR-2022-002818, datë 26.5.2022).

Rekomandimi 12.2:

“Gjithashtu DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DP AKU, të marri masat e nevojshme për pajisjen e inspektorëve me mjetet e nevojshme për marrjen e mostrës dhe transportimin e tyre në laborator”.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2021 dhe në vijimësi

Komente:

Zbatuar. Lidhur me këtë rekomandim sqarojmë se: jo vetëm për DRAKU Tiranë por për të gjitha DRAKU-të, janë blerë pajisje (frigobox) si dhe çanta speciale inspektori (mjete për marrje mostre), për marrjen dhe transportimin e mostrave. DR AKU Tiranë ka bërë kërkesë në Drejtorinë e Përgjithshme me e-mail për pajisje për marrjen e mostrave (është dërguar me e-mail kërkesa por është e pamundur të printohet pasi janë të fshirë gjitha e-maillet nga user, (bashkëngjitur materiali që është dërguar më attach) Inventari i punonjësve vërteton pajisjen e frigobox dhe valixhen (Sample Kit) e inspektorit e nevojshme për kryerjen e procedurave të marrjes së mostrave.

Rekomandimi 13.1:

“DRAKU Tiranë, për çdo rast kur është e nevojshme përfshirja e një inspektori të një sektori të caktuar pranë drejtorisë (pra inspektori i sektorit të bimëve të kryeje inspektime në subjekte që tregtojnë produkte me origjinë shtazore ose anasjelltas), në kryerjen e inspektimeve për llogari të sektorit tjetër, t'i bëjë propozim Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, me qëllim miratimin nga ky i fundit, me urdhër caktimi të Lëvizjes/transferimit paralel të inspektorit”.

Komente:

Ky rekomandim **nuk pranohet** nga subjekti i audituar.

Në lidhje me këtë rekomandim sqarojmë se në kjo situatë ka ndodhur nga mungesa në mënyrë konstante e inspektorëve. Autorizimi lëshohet nga Kryeinspektori Rajonal si një e drejtë e tij, i cili vendos edhe inspektorët pjesëmarrës apo edhe persona të tjerë që parashikon ligji. Meqenëse inspektori i ushqimit në rrethana të caktuara mund të shoqërohet nga inspektori i Mbrojtjes së Bimëve, ky i fundit kryen vetëm procedura të tilla që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me çështjet teknike, që kanë të bëjnë me natyrën e subjektit, sepse ato i kryen inspektori i fushës. Ndërkohë sqarojmë se inspektori i fushës mund ta kryejë edhe vetëm inspektimit (siç e parashikon edhe ligji “Për Inspektimin në RSH”), por për të lehtësuar procesin atij i caktohet edhe një inspektor tjetër që në këtë rast mund të jetë jo drejtpërdrejtë i fushës, por që siç theksuam, nuk kryen detyra teknike. Për këto arsye nuk mundet që të zbatohet këtë rekomandim, sepse ai kërkon burokraci dhe vonesa në procesin e inspektimit, duke cenuar seriozisht atë (shembull rastet e denoncimeve apo indiceve nuk mund të kryhen me vonesa).

Rekomandimi 14.1:

“DP AKU, Sektori i Auditit të Brendshëm, të marri masat e nevojshme duke analizuar mundësitë për planifikimin dhe kryerjen e auditimeve në 12 Drejtoritë Rajonale të AKU-së, me fokus shqyrtimin dhe vlerësimin e Ligjshmërisë së procedurës së inspektimit të produkteve të importit, ndjekur nga inspektorët e pikave kufitare, me qëllim identifikimin e mangësive, rregullimin e tyre dhe ngarkimin me përgjegjësi ligjore të personave përkatës, duke rritur në këtë mënyrë përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e punonjësve në institucion”.



Komente:

Ky rekomandim **është i zbatuar**, pasi është audituar sektori i monitorimit të PIK në DP AKU gjatë auditimit të kryer në vitin 2022. Nga ana tjetër, me rekomandimet e mëparshme nga sektori i auditimit, Sektori i monitorimit të PIK në DP AKU, është në fazën e hartimit të metodologjisë së kontrollit të procedurave që kryhen në pik dhe dokumentacionit shoqëruës gjatë importit / eksportit dhe tranzitimit, veprimtari e cila është shtuar në detyrat funksionale të këtij sektori në rregulloren e brendshme. Gjithashtu sektori i auditimit të brendshëm, në kuadër të hartimit të planit vjetor strategjik për vitet 2023 – 2025, do ketë në konsideratë rekomandimin e Grupit të KLSH-së duke planifikuar auditimit e sektorit të PIK në DRAKU e vartësisë.

Rekomandimi 15.1:

“DP AKU në çdo rast kur vlerëson të nevojshëm kryerjen e inspektimeve (përfshiruar ato të iniciuara nga ankesat/indiciet), jashtë planit vjetor të kontrollit zyrtar të miratuar nga Ministri përgjegjës për bujqësinë, të bëjë propozimin shoqëruar me relacion shpjegues pranë MBZHR-së, dhe pritjen nga kjo e fundit të miratimit/refuzimit të propozimit, me qëllim shmangien e efekteve ligjore dhe financiare që mund të krijohen nga zbatimi i urdhrave të paligjshëm, si dhe duke forcuar në këtë mënyrë edhe elementët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në institucionin e AKU-së”.

Në vijimësi

Komente:

Proces

Rekomandimi 16.1:

“DP AKU të marrë masat e nevojshme që për çdo rast, dokumentet standarde të laboratorit (autokontroll dhe kontroll zyrtar) të plotësohen saktë në formë dhe përmbajtje. Gjithashtu të mos lejohet marrja pjesë e përgjegjësit të laboratorit në analizat laboratorike me qëllim shmangien e konfliktit të interesit, si dhe në rastet kur sasia e kampionit të sjellë (autokontroll dhe kontroll zyrtar) nuk është sipas kërkesave teknike, mostra të refuzohet”.

Në vijimësi

Komente:

Në lidhje me këtë rekomandim sqarojmë se P/Sek Laboratorit nuk merr pjesë në kryerjen e analizave, por në zbatim të urdhrit nr. 24 të Ministrit të Linjës ai duhet të konfirmojë analizën e kryer nga specialistët e fushës në sektorin e Laboratorit. Nga AKU janë ndërmarrë veprimet e cilët kanë të bëjnë me përmirësimin e procedurave të pranimit të mostrave në laborator. Bashkëlidhur shkresa nr. 182/1, datë 26.02.2021 si dhe një procedurë e kryer nga sektori i laboratorit (nga momenti i marrjes së mostrës nga ana e pritësit i cili në rastin konkret është P/Sek Laboratorit deri tek përfundimi i analizës i cili dokumentohet me raport prove). Gjithashtu DP AKU ka kërkuar zhvillimin e trajnimeve për stafin dhe unifikimin e metodave laboratorike, ISUV-it si laborator reference si dhe Ministrisë së Linjës (shkresat nr. 1339 prot., datë 04.03.2022, nr. 1394, datë 09.03.2022, shkresa nr. ë70 , datë 08.09.2022.

Rekomandimi 17.1:

“DRAKU Tiranë të kontabilizojë dhe të pasqyrojë në bilancin financiar Godinën-3-kat të AKU Tiranë, bazuar në situacionin dhe akt kolaudimin përfundimtar të objektit”.

Në vijimësi

Komente:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe është **zbatuar** Në zbatim të këtij rekomandimi, është iniciuar procedura për nisjen e hipotekimit të ndërtesës dhe mbledhjen e dokumentacionit, dokumentacioni për regjistrimet e pronësisë (ndërtesat e DRAKU-ve), procesin e ndjek Sektorit i Buxhetit dhe Financës si dhe një grup pune i ngritur në MBZHR për hipotekimin e 9 godinave



të AKU-së në qarqe. (E-mail mbi procesin e hipotekimit datë 10.6.2022 I DP AKU, shkresat nr. 2501, datë 15.12.2021, Nr. 138, datë 25.1.2022, Nr. 668, datë 30.3.2022, Nr. 1935, datë 10.5.2022, Nr. 1335/2, datë 28.7.2022, shkresa 4599, datë 08.08.2022).

Rekomandimi 18.1:

"DRAKU Tiranë në të ardhmen të eliminojë inspektimet me 2 standarde, duke përdorur një standard inspektimit për gjitha subjektet, në zbatim të kërkesave ligjore, në mënyrë që të mos diskriminojë dhe diferencojë subjektet, të cilat shpesh janë bërë objekt ankesash dhe pakënaqësish ndaj inspektimeve të kryera".

Në vijimësi

Komente:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe është duke u **zbatuar**. Përfaqësues të DRAKU Tiranë në bashkëpunim kanë hartuar draft-metodologji e përcaktimit të masave administrative në fushën e inspektimit e cila na është dërguar në ministrinë e linjës me shkresën nr. 2938 prot., datë 18.05.2022.

Rekomandimi 19.1:

"DRAKU Tiranë të marrë masa që inspektimet e filluara me kërkesën e subjekteve të mos anulohen pa arsye brenda ditës, në rast se subjektet e inspektimit gjenden të mbyllura të justifikohen me foto, sipas rregullores së procedurës së inspektimit, si dhe shkeljet e konstatuara në inspektimet e kryera të shoqërohen me dokumente provuese, kryesisht në inspektimet tematike".

Në vijimësi

Komente:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar pjesërisht** dhe është **zbatuar**, në rastin e konstatimit të subjekteve të mbyllura në momentin e kontrollit ju bashkëngjitet foto demonstruese. Shembull: praktike inspektimi Nr. AKU-TR-2022-004814, datë 13.9.2022

Rekomandimi 20.1:

"DRAKU Tiranë të marrë masat që inspektimet të jenë të plota, të trajtojnë të gjitha problemet e legjislacionit dhe kjo duke u mjaftuar vetëm me kushtet higjiena-sanitare, gjendjen e godinave dhe ambienteve të tyre, të cilat përfaqësojnë një pjesë të inspektimit".

Në vijimësi

Komente:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe është **zbatuar**, praktikë dhe check-lista bashkëlidhur e një inspektimi të plotë konkretisht autorizimi nr. AKU-TR-2022-00323

Rekomandimi nr. 20.2.

Zbatuar. Në lidhje me afatet për mostrat e dërguara në ISUV, bazuar në udhëzimin nr. 12, datë 01.06.2021, për një shtesë në udhëzimin nr. 3, datë 18.01.2021 "Për miratimin e planit kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjen e bimëve dhe inuteve bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIK", pika 6 përcakton se, afati i raportimit në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe AKU, nga ISUV, të jetë jo më shumë se 45 ditë nga marrja e mostrës, përjashtuar rastet pozitive ku raportimi do të jetë i menjëhershëm. Bashkëlidhur shkresa nr. 142 prot., datë 08.02.2022, nr. 3161 prot., datë 26.08.2021.

Rekomandimi nr. 21.1: DRAKU Tiranë të marrë masat e nevojshme, për analizimin e produkteve PMB, duke përgatitur Planin Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me bazë risku dhe



të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjen e bimëve dhe inpleteve bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIK, para hartimit të buxhetit të ISUV për të parashikuar nevojën për reagent dhe standardet e nevojshme për hartimin e tyre.

Komente: Zbatuar., Në lidhje me këtë rekomandim sqarojmë se janë bërë parashikimet e duhura në udhëzimin nr. 3, datë 18.01.2021 "Për miratimin e planit kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë rrisht dhe marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjen e bimëve dhe inpleteve bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIK" i cili është dërguar në ministrinë e linjës dhe IQ për miratim.

Rekomandimi nr. 22.1: DRAKU Tiranë të bëj plotësimin e listë-verifikimit për të gjithë inspektimet, si dhe në rastet kur subjektet kanë mungesë të produkteve, të bëhen komentet në kategorinë përkatëse.

Koment: **Zbatuar**, bashkëlidhur praktika nr. autorizimi AKU-TR-2022-004685-1 (PMB) dhe nr. autorizimi AKU-TR-2022-000924-1.

Rekomandimi nr. 23.1: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marrin masat për hartimin dhe miratimin e rregullores së përcaktimit të vlerës së gjobës, manualit të inspektimit, ku gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës për llojin e shkeljes, të merret në konsideratë historiku dhe frekuenca e shkeljeve të subjektit në vitin paraardhës, me qëllim shmangien e qëndrimit subjektiv të inspektorit në përcaktimin e masës së gjobës përballë shkeljeve të subjektit.

Komente: Zbatuar, në lidhje me këtë rekomandim sqarojmë se është hartuar draft - metodologji e përcaktimit të masave administrative në fushën e inspektimit e cila na është dërguar në ministrinë e linjës me shkresën nr. 2938 prot., datë 18.05.2022. Në lidhje me manualin, në zbatim të tij bashkëlidhur urdhëratë Nr. 5537 Prot., datë 20.9.2022, Nr. 5281 Prot., datë 09.09.2022.

Rekomandimi nr. 24.1: DPAKU në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, të marrin masat për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të AKU-së, ku veç të tjerave të përcaktohet afati konkret për shqyrtimin e ankesave/indicieve që vijnë nga konsumatorët, grupe interesi. Gjithashtu në Kreu-n përkatës të kësaj rregullore, të përcaktohen rregulla të qarta për sektorin e laboratorit, mbi administrimin e mostrave (për të shmangur edhe konfliktin e interesit), dokumentet standard që duhet të përdoren, etj.

Komente: Rekomandimi pranuar dhe zbatuar, Urdhri Ministrit nr. 297, datë 23.06.2022. Në lidhje me parashikimin e afateve të shqyrtimit të ankesa/indicio etj., në bazë të ligjit për bashkëqeverisjen janë përcaktuar afate të cilat janë 10 ditore dhe nëse ka nevojë për shtyrje, njoftohen palët përkatëse.

Rekomandimi nr. 24.2: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU si edhe me Ministrinë e Bujqësisë, të marrin masat e nevojshme, për ngritjen e një grupi të përbashkët pune, për hartimin dhe miratimin e rregullores së procedurës së arkëtimit të gjobës nga momenti i vënies së gjobës nga inspektorët, ankimi, shqyrtimi i ankimit nga komisioni përkatës, përcjellja e vendimit nga DPAKU-DRAKU ose MBZHR-DPAKU-DRAKU, masat që duhet të merren nga DRAKU për vënien në ekzekutim si dhe monitorimin periodik të veprimeve të ndërmarra nga përmbaruesit për ekzekutimin e detyrimit.

Komente: Nga subjekti i audituar nuk kuptohet qartësisht për faktin se procedura nga momenti i vendosjes së gjobës dhe deri në arkëtimin e saj, janë të përcaktuara ligjërisht, pra nuk kemi mungesë të akteve rregullative për këtë proces.



Rekomandimi nr. 25.1: DPAKU në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, të manin masat e nevojshme, që në Urdhrin e mësipërm, të përcaktohet afati minimal dhe maksimal i nxjerrjes së rezultatit laboratorik, të përcaktohen kushtet teknike për pranimin e mostrave për analiza-fiziko-kimike.

Komente: i papranuar, Në lidhje me përcaktimin e kushteve teknike për pranimin e mostrave, sqarojmë se me urdhrin nr. 24, datë 30.01.2013 është bërë shfuqizimi i shtojcës nr. 3, me urdhrin nr. 15, datë 09.09.2021 nga ana e Ministrisë së linjës.

Sa i përket rekomandimit tuaj i cili ka të bëjë me afatin minimal dhe maksimal të nxjerrjes së rezultatit të analizave, i referohemi standardeve ISO të përcaktuara në Udhëzimin nr. 15, datë 09.09.2021 dhe në këtë kontekst ndërhyrja tek urdhri nr. 24, **mendojmë që nuk është efektive.**

III.4 Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Rekomandimi nr. 1.1: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DP AKU, të përcjellin pranë zyrave të përmbarimit, vendimet e mësipërme të gjykatës, me qëllim vënien në ekzekutim dhe arkëtimin e gjobave në vlerën 3.150.000 lekë.

Komente: Rekomandimi konsiderohet **ne proces.** Nga DR AKU Tiranë për sa i përket ndjekjes në Gjykatën Administrative të Apelit. Me shkresë nr. 1958, datë 07.10.2021 "Kërkesë për informacion" Gjykatës Administrative të Apelit.

Me shkresën "Kthim përgjigje" Nr. 1958/1 Prot., datë 18.10.2021 bëhemi me dije se çështjet akoma nuk kanë datë planifikimi nga ana e gjyqtarëve relator, aktualisht po gjykojnë çështjet e regjistruara në vitin 2016. Pritet vendimi i Gjykatës së Apelit, që të vijohet ndjekja e procedurës nga DP AKU për kontabilizimin dhe rimarrjen në shqyrtim nga Komisioni.

Subjekti R. C, masë administrative gjobë shfuqizuar me vendim Komisioni nr. 7698/1, datë 04.11.2020, hequr nga Kontabiliteti.

Rekomandimi nr. 2.1: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DP AKU të marri masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, për vlerën 350.000 lekë, përkatësisht nga personat përgjegjës të pasqyruar në tabelën nr. 31, Kap., Aneksi nr. 7.

Komente: Nuk pranohet, për faktin se ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet administrative" në nenin 44 parashikon masë disiplinore (deri në largim nga detyra) për punonjësit të cilët nuk kanë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ dhe nuk parashikon që punonjësi të detyrohet për të paguar gjobën e pa arkëtuar. Ndërkohë sqarojmë se nuk ka një vendim parashkrimi të Titullarit të DRAKU-së Tiranë për faktin se disa prej gjobave të cituara nga ana Juaj, janë në proces ekzekutimi dhe në tërësi ato nuk mund të konsiderohen pa shpresë arkëtimi, pasi institucioni po bën përpjekjet e duhura për vënien në ekzekutim të tyre.

Rekomandimi nr. 3.1: DRAKU Tiranë të marrë masat për arkëtimin e tatimit mbi të ardhurat për vlerën 276.325 lekë ndaj E. Sh, pasi nuk është ndalur nga paga e përfituar, sipas urdhër shpenzimit nr. 82, datë 13.05.2020 dhe Vendimit Gjykatës Apelit nr. 3320, datë 20.12.2019.



Komente: Zbatuar, referuar urdhrin nr. 1043, datë 02.06.2021, likuiduar shuma totale bashkëlidhur list-pagesat sipas muajve.

Rekomandimi nr. 4.1: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DP AKU, të marri masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, për vlerën 266.000 lekë, përkatësisht nga përmbaruesi gjyqësor privat z. R. A.

Komente: Rekomandimi është zbatuar nga DR AKU Tiranë, referuar shkresave Nr. 2614, datë 22.12.2021, Nr. 2553, datë 17.12.2021, Nr. 5030, datë 12.9.2022. Në proces për ndjekjen nga DP AKU.

Rekomandimi nr. 5.1: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DP AKU, të marri masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, për vlerën 48.000 lekë, nga zyra përmbarimore e ngarkuar me ekzekutimin e detyrimit.

Komente: Rekomandimi është zbatuar nga DR AKU Tiranë, referuar shkresave Nr. 2553, datë 17.12.2021, Nr. 2547, datë 17.1.2021, Nr. 2560, datë 17.1.2.2021, Nr. 2559, datë 17.12.2021, Nr. 2558, datë 17.12.2021, Nr. 2557, datë 17.12.2021, Nr. 2556, datë 17.12.2021, Nr. 2555, datë 17.12.2021, Nr. 2554, datë 17.12.2021, Nr. 2551, datë 17.12.2021, Nr. 2550, datë 17.12.2021, Nr. 2549, datë 17.12.2021, Nr. 2548, datë 17.12.2021, Nr. 2546, datë 17.12.2021, Nr. 2545, datë 17.12.2021, Nr. 5030, datë 12.9.2022.

Lidhur me kamatëvonesat Gjykata Administrative mban qëndrime të ndryshme në venimin për çelje urdhrash ekzekutimi, pavarësisht se nga pala kreditore në kërkesën për lëshim urdhri ekzekutimi kërkohen kamatëvonesat, gjykata mban 3 qëndrime:

1. Nuk i njeh kamatëvonesat, dhe të jep të drejtën e ankimit, raste të cilat ankimohen në Apel (kërkesa nr. 2325 Prot., datë 03.12.2020, Vendim nr. 1581, datë 15.12.2020, Ankim në Apel nr. 154/1, datë 27.1.2021)
2. I njeh kamatëvonesat (urdhër nr. 204, datë 3.02.2021 vendimtar nga A. A)
3. Nuk shprehet në dispozitivin e urdhrin për kamatëvonesat vetëm për gjobën. (shembull Kërkesa nr. 1330, datë 7.7.2021, vendim nr. 270, datë 13.9.2021, kërkesa Nr. 2500, datë 28.12.2022, vendim nr. 1558, datë 7.12.2020).

Rekomandimi nr. 6.1: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DP AKU, të marri masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, për vlerën 23.750 lekë, përkatësisht nga 9 subjektet që kanë përfituar shërbimin e analizës laboratorike, pasqyruar në tabelën nr. 32, KAP., Anekse, aneksi nr. 7.

Komente: Zbatuar, bashkëlidhur dokumentacioni provues fatura arkëtimi dhe situacioni thesari.

Rekomandimi nr. 7.1: Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Tiranë, sektori i financës të arkëtojë vlerën 16.100 lekë, për 23 kg mish të pa administruar në magazinën e institucionit, bllokuar/sekuestruar për pasiguri ushqimore, në ngarkim të Z. C, E. Ç dhe A. N, me nga 5,366 lekë/secili.

Rekomandimi nr. 8.1: DRAKU Tiranë të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, për vlerën 9.000 lekë, përkatësisht nga z. N. H, dhe z. A. N inspektor, 4.500 lekë/secili.



Rekomandimi nr. 9.1: DRAKU Tiranë të arkëtojë vlerën 7,000 lekë gjoba, për tejkalim afati për kontrollin vjetor teknik të 7 automjeteve, përkatësisht A. N dhe N. Ç me nga 3,500 lekë/secili.

Komente: rekomandimet 7.1, 8.1 dhe 9.1 janë zbatuar, bashkëlidhur list-pagesat e mbajtjes së detyrimeve të inspektorëve.

III.5 Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Rekomandimi nr. 1.1: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimit të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbauesit gjyqësor privat, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/palujtshme), për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamat-vonesa). Për çdo rast, kur nga përmbauesit nuk merren të gjitha masat e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit, DPAKU t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim që nga kjo e fundit të aplikohen penaltete ndaj përmbauesve. Në këtë mënyrë, kjo praktikë do të shërbejë për rritjen e përgjegjshmërisë dhe efektivitetit të bashkëpunimit të AKU me zyrat e përmbaimit. Për dy rastet, në të cilat nuk është kërkuar për arkëtim kamat-vonesa, të njoftohet shërbimi i përmbaimit për arkëtimin e tyre, duke shmangur dëmin ekonomik që mund të shkaktohet ndaj buxhetit të shtetit, në të ardhmen.

Gjithashtu 23 gjobat në vlerën 18,334,000 lekë t'i përcillen për shqyrtim dhe vendimmarrje Komisionit të DPAKU-së ose Komisionit të posaçëm në MBZHR, sipas kompetencës ligjore.

Komente: Zbatuar. Sektori i Ankimeve Administrative Gjyqësore, merr në vazhdimësi informacion nga zyrat përmbaimore për çdo rast në veçanti (të cilat në zbatim të kontratës së lidhur e dërgojnë një kopje në DP për çdo veprimin që kryejnë, njoftim për ekzekutim vullnetar, njoftim për ekzekutim të detyrueshëm, njoftim bankave të nivelit të dytë etj) si dhe cdo 3 apo 6 muaj informacion të plotë për të gjitha rastet që kanë në trajtim. DR AKU Tiranë ka kërkuar informacion në vazhdimësi për statusin e gjobave që janë në ekzekutim me shkresa dhe e-mail. (bashkëlidhur shkresat nr. 131 prot., datë 24.1.2022, nr. 130, datë 24.1.2022, nr. 2546/1, datë 14.1.2022, nr. 2550/1, datë 10.1.2022, nr. 90, datë 19.01.2022, e-mail nga shërbimi Përmbaimit B&I, informacion i përditësuar nga bankat e nivelit të dytë), me shkresat Nr. 2553, datë 17.12.2021, Nr. 2547, datë 17.1.2021, Nr. 2560 datë 17.1.2021, Nr. 2559, datë 17.12.2021, Nr. 2558, datë 17.12.2021, Nr. 2557, datë 17.12.2021, Nr. 2556, datë 17.12.2021, Nr. 2555, datë 17.12.2021, Nr. 2554, datë 17.12.2021, Nr. 2551, datë 17.12.2021, Nr. 2550, datë 17.12.2021, Nr. 2549, datë 17.12.2021, Nr. 2548, datë 17.12.2021, Nr. 2546, datë 17.12.2021, Nr. 2545, datë 17.12.2021, Nr. 5030, datë 12.9.2022 (cituar edhe në rekomandimin nr. 5.1 (masa shpërbllim dëmi) u është kërkuar mbledhja e kamat vonesave përmbauesve, për dijëni dhe Drejtoria e Përgjithshme.

Në shembujt bashkëlidhur rezulton që Përmbauesit dhe gjykata nuk mbajnë një qëndrim. Ka urdhra në të cilat gjykata nuk e njeh në diapozitivin e tij mbledhjen e kamatëvonesës dhe përmbauesi e përllogarit, dhe ka përmbaues te tjerë të cilët nuk e mbledhin kryesisht.

E njëjta situata është edhe për vendimmarrjen e gjykatës trajtuar edhe në pikën C, Rekomandimin 5.1. Lista e debitorëve me statusin e tyre e përditësuar njoftohet çdo muaj në



DP AKU, me e-mail njoftuar edhe gjobat të cilat nuk janë shqyrtuar nga Komisioni, si bashkëlidhur).

Rekomandimi nr. 2.1

DPAKU të marrë masa për shqyrtimin e përgjegjësive dhe vendosjen e masave administrative ndaj personave ish-drejtues të AKU, pavarësisht se ata janë larguar në vende pune të tjera, pasi kanë shkaktuar efekte negative financiare në buxhetin e shtetit për vlerën 3,531,426 lekë, si rezultat i largimeve të punonjësve nga puna pa u bazuar në legjislacionin në fuqi, sipas Vendimeve Gjykatës Apelit.

Rekomandimi pranohet pjesërisht dhe në proces. Vlerësojmë se ky rekomandim i takonte organit epror (Ministrisë së linjës) megjithatë AKU do të kryejë procesin e analizimit në lidhje me procedurat e ndjekura për largimin e punonjësve nga detyra, sipas çdo rasti. E ndjek Drejtoria e Shërbimeve të brendshme (Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori Juridik.

II.6 Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Rekomandim i zbatuar. Në lidhje me këtë rekomandim bashkëlidhur po iu dërgojmë tabelën përkatëse sipas llojit të masës së marrë kundrejt punonjësve të cituar në Raportin e Auditimit të KLSH.

Rekomandimi nr. 2.1: DPAKU të marrë masa për shqyrtimin e përgjegjësive dhe vendosjen e masave administrative ndaj personave ish-drejtues të AKU, pavarësisht se ata janë larguar në vende pune të tjera, pasi kanë shkaktuar efekte negative financiare në buxhetin e shtetit për vlerën 3,531,426 lekë, si rezultat i largimeve të punonjësve nga puna pa u bazuar në legjislacionin në fuqi, sipas Vendimeve Gjykatës Apelit.

Komente: Duke qenë se ish Drejtuesit e AKU-së janë të larguar nga administrata publike, është e pamundur të ekzekutohen masa organizative, kjo referuar dhe standardit të përdorur nga grupi auditimit të KLSH, në rubrikën rekomandime për dhënie masa disiplinore, pika D.2.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

1. Gjetje nga auditimi: Nga DRAKU Tiranë paraqitet një nivel i lartë i zbatimit të rekomandimeve, ku nga 63 rekomandime janë zbatuar dhe në proces zbatimi 91% e rekomandimeve të lëna nga KLSH. Niveli i pazbatueshmërisë paraqitet në masën 9%, për rekomandime të cilat nuk janë pranuar nga subjekti.

Për masat organizative, DRAKU Tiranë nuk ka pranuar rekomandime si më poshtë:

-DRAKU Tiranë dhe DRAKU nuk ka pranuar dhe zbatuar rekomandimin 1.1 që në bashkëpunim me MBZHR, në mbështetje të neneve 111, 113 dhe 114 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të marrin masat e nevojshme, për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve të mësipërme për 21 gjobat, me qëllim anulimin e tyre dhe rivendosjen e ligjshmërisë, si dhe përcjelljen 19 gjobave (përfshirë 2 gjoba të cilat janë në shkallën e dytë të gjyqimit) pranë Komisionit të posaçëm në MBZHR për shqyrtimin nga e para dhe vendimmarrje të mëtejshme”.

-DRAKU Tiranë nuk ka pranuar dhe zbatuar rekomandimin 6.1 që të marrë masat e nevojshme që për çdo mostër të sjellë nga kontrolli zyrtar, treguesit që do të analizohen të përcaktohen nga specialistët e laboratorit, si dhe nga inspektorët në fletë-shoqërimin e mostrës të përcaktohet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021” NË DRAKU TIRANË

qartë se në çfarë kushtesh është ruajtur produkti prej nga është marrë mostra, duke shërbyer si tregues për laboratorin në përcaktimin e treguesit që do të analizohet.

-DRAKU Tiranë nuk ka pranuar dhe zbatuar rekomandimin nr. 10.1 që të marrë masat e nevojshme, që në çdo rast të refuzimit të aplikimit për licencim, të bëjë ndalimin e ushtrimit të aktivitetit si dhe përcaktimin e afatit konkret për rregullimin e mangësive”.

-DRAKU Tiranë nuk ka pranuar dhe zbatuar rekomandimin nr. 13.1 që për çdo rast kur është e nevojshme përfshirja e një inspektori të një sektori të caktuar pranë drejtorisë (pra inspektori i sektorit të bimëve të kryeje inspektime në subjekte që tregtojnë produkte me origjinë shtazore ose anasjelltas), në kryerjen e inspektimeve për llogari të sektorit tjetër, t'i bëjë propozim Drejtorit të Përgjithshëm të AKU- së, me qëllim miratimin nga ky i fundit, me urdhër caktimi të Lëvizjes/transferimit paralel të inspektorit”.

-DRAKU Tiranë nuk ka pranuar dhe zbatuar rekomandimin nr. 25.1 që në bashkëpunim me DPAKU dhe Ministrinë e Bujqësisë, të manin masat e nevojshme, që në Urdhrin e mësipërm, të përcaktohet afati minimal dhe maksimal i nxjerrjes së rezultatit laboratorik, të përcaktohen kushtet teknike për pranimin e mostrave për analiza-fiziko-kimike.

Për masat për shpërblim dëmi, DRAKU Tiranë nuk ka pranuar rekomandimin si më poshtë:

- DRAKU Tiranë nuk ka pranuar rekomandimin nr. 2.1 që në bashkëpunim me DP AKU të marri masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, për vlerën 350.000 lekë, përkatësisht nga personat përgjegjës të pasqyruar në tabelën nr. 31, në Kap., Aneksi nr. 7.

Rekomandim 1.1: DRAKU Tiranë të marrë masa që të rivlerësojë edhe njëherë rekomandimet përkatëse.

V. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT

Pjesë përbërëse e Projektraportit të Auditimit është dhe dokumentacioni i mbajtur si më poshtë:

-Akt Verifikimi Nr. 1 datë 22.09.2022 “Mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna për vitin 2021”.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT